



**RIINVEST**  
**VLERË**

**KUVENDI I AKSIONARËVE**

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutit të BPrAL Kolegji Riinvest sh.a., Kuvendi i Aksionarëve të BPrAL Kolegji Riinvest sh.a. në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të Aksionarëve, të mbajtur në Prishtinë më 16 nëntor 2017, miratoi këtë:

## **RREGULLORE TË PUNËS SË KUVENDIT TË AKSIONARËVE TË BPrAL KOLEGJI RIINVEST sh.a.**

### **KREU I – DISPOZITAT E PËRGIJTHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

1.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave të punës së Kuvendit të Aksionarëve (në tekstin e mëtejshëm Kuvendi) të BPrAL Kolegji Riinvest sh.a. (në tekstin e mëtejshëm Shoqëria ose Kolegji), në pajtim me dispozitat dhe obligimet e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë dhe në ligjet e zbatueshme.

1.2 Me këtë Rregullore përcaktohen dispozitat lidhur me:

- a. Përgatitjen dhe konvokimin e mbledhjeve (seancave) të Kuvendit të Aksionarëve,
- b. Udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit të Aksionarëve,
- c. Mënyrën e aprovimit të vendimeve dhe konkluzioneve të Kuvendit të Aksionarëve, dhe
- d. Mbajtjen e dokumentacionit për punën e Kuvendit të Aksionarëve.

1.3 Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj Rregulloreje bie ndesh me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, ligjet tjera të zbatueshme për Kolegjin apo Statutin e Shoqërisë, dispozitat e saj do të jenë të pavlefshme, ndërsa do të zbatohen dispozitat e akteve tjera të listuara në këtë paragraf.

1.4 Në rast të mbajtjes së Kuvendit të Aksionarëve si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës kompetente, punimet e tij do të rregullohen në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe udhëzimeve specifike në vendimin e Gjykatës.

#### **Neni 2 Mbledhjet e Kuvendit**

2.1 Kuvendi punimet e veta i kryen në mbledhje plenare të të gjithë aksionarëve të regjistruar në Listën e Aksionarëve 30 ditë para mbajtjes së planifikuar të Kuvendit të Aksionarëve. Kjo Listë e Aksionarëve duhet të përmbajë emrin dhe adresën e secilit aksionar aktual si dhe numrin dhe llojin e aksioneve me të cilat aktualisht disponojnë, dhe informacionet tjera që duhet të shënohen në të në bazë të ligjeve të zbatueshme në Kosovë.

2.2 Mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve mund të jenë të rregullta (Kuvend i Rregullt) dhe të

jashtëzakonshme (Kuvend i Jashtëzakonshëm).

2.3 Kuvendi i Aksionarëve do të mbajë një Kuvend të Rregullt në vit, jo më vonë se deri në fundin e muajit të tretë pas përfundimit të çdo viti kalendarik, si dhe jo më vonë se dy muaj pas pranimit të raportit të auditimit të Shoqërisë.

2.4 Kuvendet e Jashtëzakonshme mund të konvokohen në çdo rast kur një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme.

2.5 Kuorumi i Kuvendit të Aksionarëve konsiderohet se është plotësuar në çdo rast kur në mbledhjet e Kuvendit që janë thirrur në pajtim me dispozitat ligjore dhe të akteve të Shoqërisë janë të pranishëm aksionarët ose personat e autorizuar të aksionarëve që janë pronarë të së paku 50.01% të aksioneve të Shoqërisë. Përbërësit e kësaj dispozite, në rastet kur në rendin e ditës së Kuvendit janë vendosur çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje sipas nenit 12.5 të Statutit të Shoqërisë, atëherë kuorumi në mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve konsiderohet se është arritur kur të pranishëm në Kuvend janë së paku 2/3 dy të tretat e të gjitha aksioneve të Shoqërisë.

2.6 Në Kuvend, aksionarët marrin pjesë personalisht apo mund ta emërojnë një përfaqësues për të votuar në emër të aksioneve të tyre, me autorizim me shkrim. Autorizimi i përfaqësimit duhet të theksojë shprehimisht se përfaqësuesi e ka të drejtën që të votojë për aksionet e aksionarit që ka dhënë autorizimin. Një kopje e këtij Autorizimi duhet t'i dërgohet Kryetarit të Kuvendit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Shoqërisë, para fillimit të mbledhjes. Autorizimi i tillë mund të jetë për një Kuvend të caktuar, për një periudhë të caktuar apo pa kufizim kohor.

2.7 Kuvendet e Aksionarëve do të mbahen në selinë e Kolegjit në Prishtinë, apo në ndonjë vend tjetër në Kosovë që mund të përcaktohet nga Bordi Drejtues në ftesën për Kuvend të Aksionarëve.

## **KREU II - KONVOKIMI I KUVENDIT TË AKSIONARËVE**

### **Neni 3**

#### **Konvokimi i Kuvendit të Rregullt**

3.1 Kuvendet e Rregullta i konvokon Bordi Drejtues, me vendim. Në rast të dështimit të thirrjes dhe organizimit të Kuvendit të Rregullt nga Bordi Drejtues, të drejtën e thirrjes së tij e kanë aksionarët që kanë në pronësi të tyre së paku 10% të të gjitha aksioneve të Shoqërisë.

3.2 Moskonvokimi dhe mosmbajtja e Kuvendit të Rregullt nga Bordi Drejtues në kohën e përcaktuar në këtë Rregullore mund të konsiderohet dështim i Bordit Drejtues në realizimin e obligimeve të veta, por nuk ndikon në veprimtarinë e vlefshme dhe ligjshme të shoqërisë. Megjithatë, ky dështim menjëherë u jep aksionarëve të drejtën, që mund të ushtrohet nga një ose më shumë aksionarë që mbajnë së paku 10% të votave me të drejtë vote në mbledhjen vjetore, që të konvokojnë dhe mbajnë mbledhjen vjetore

të aksionarëve. Në rast të tillë, ftesat për Kuvendin e Rregullt do të dërgohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit.

3.3 Në Kuvende të Rregullta mund të merren vendime vetëm për çështje që bien nën fushëveprimin e njoftimit dhe rendit të ditës që është dërguar paraprakisht, apo në fushëveprimin e propozimeve të dërguara tek Bordi Drejtues sipas procedurës së përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje. Megjithatë, ky kufizim nuk është i zbatueshëm për diskutimin e çështjeve tjera gjatë Kuvendit të Rregullt.

#### **Neni 4**

#### **Konvokimi i Kuvendit të Jashtëzakonshëm**

4.1 Kuvendi i Jashtëzakonshëm mund të thirret nga Bordi Drejtues, me vendim, kurdo që ai konsideron se është shfaqur nevoja apo janë përmbushur kushtet që Kuvendi i Aksionarëve të trajtojë apo vendosë mbi ndonjë çështje që është në kompetencë të tij.

4.2 Kuvendi i Jashtëzakonshëm mund të thirret edhe nga zotëruesit e së paku 10% të aksioneve të Shoqërisë, të cilët kërkesën për mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm ia paraqesin Kryetarit të Kuvendit dhe Bordit Drejtues. Nëse Kuvendi i Jashtëzakonshëm thirret në bazë të këtij paragrafi, pronarët e më së paku 10% të të gjitha votave kanë të drejtë të propozojnë qëllimin, çështjen apo çështjet që do të diskutohen dhe rendin e ditës për Kuvendin e Jashtëzakonshëm. Kërkesa për Kuvend të Jashtëzakonshëm bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë emrat dhe adresat e aksionarëve, numrin e aksioneve që ata i zotërojnë, datën dhe nënshkrimet e të gjithë aksionarëve që parashtrajnë kërkesën. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës nga Bordi Drejtues, ai duhet ta miratojë vendimin për caktimin ose refuzimin e mbledhjes. Brenda pesë ditëve pas miratimit të këtij vendimi, Bordi Drejtues duhet t'u dërgojë njoftim për mbajtjen e mbledhjes personave që kanë paraqitur kërkesën në adresën e shënuar në kërkesë, së bashku me një kopje të vendimit. Nëse kërkesa për caktimin e mbledhjes së jashtëzakonshme refuzohet, atëherë vendimi i refuzimit duhet të theksojë edhe arsyet për refuzimin e mbledhjes.

4.3 Vendimi i Bordit Drejtues për refuzimin e mbledhjes mund të miratohet vetëm nëse procedurat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni nuk janë përmbushur, ose nëse aksionarët që kanë paraqitur kërkesën nuk e posedojnë numrin e mjaftueshëm të votave që kërkohen sipas këtij paragrafi, ose nëse asnjëra nga çështjet e propozuara në kërkesë për mbledhje nuk është në kompetencën e mbledhjes së aksionarëve.

4.3 Në Kuvende të Jashtëzakonshme mund të votohet vetëm për çështjet për të cilat ai është konvokuar në bazë të rendit të ditës që u është dërguar aksionarëve, por ky kufizim nuk është i zbatueshëm për diskutimin e çështjeve tjera gjatë tyre.

## **Neni 5**

### **Ftesat për Kuvend dhe Rendi i Ditës së Kuvendit**

5.1 Njoftimi me shkrim për mbajtjen e Kuvendit të Rregullt të Aksionarëve duhet të dorëzohet jo më pak se tridhjetë (30) ditë dhe jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së mbajtjes, ndërsa njoftimi me shkrim mbi mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Aksionarëve duhet të dorëzohet jo më pak se njëzet (20) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë para datës së mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme. Njoftimi për Kuvend, përveç rasteve të rregulluara me nenin 3 të kësaj Rregulloreje, dërgohet nga Kryetari i Bordit Drejtues, ose me udhëzimin e tij, ose nga Bordi i Drejtorëve, dhe u dërgohet të gjithë aksionarëve me të drejtë vote.

5.2 Njoftimi për mbajtjen e Kuvendit të Rregullt duhet të përmbajë datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, rendin e propozuar të ditës dhe një listë të çështjeve për të cilat duhet votohet (përfshirë listën e kandidatëve të propozuar për emërim), dhe të gjitha çështjet tjera që duhet të përfshihen në njoftim në bazë të Statutit dhe kësaj Rregulloreje. Njoftimi gjithashtu duhet të përfshijë raportin vjetor të shoqërisë, llogarinë vjetore, deklaratën e fitimeve dhe humbjeve vjetore dhe raportin e auditimit. Bordi i drejtorëve është i obliguar që të sigurojë që të gjitha këto dokumente ose t'u dërgohen ose të jenë në dispozicion të aksionarëve së paku tridhjetë (30) ditë para mbledhjes.

5.3 Rendi i ditës së Kuvendit do të përcaktohet nga Bordi Drejtues, me vendim, dhe do t'u dërgohet aksionarëve krahas njoftimit për mbajtjen e tij. Aksionarët që janë bartës të së paku 10% të aksioneve mund të kërkojnë përfshirjen e jo më shumë se dy pikave të reja në rendin e ditës, duke kërkuar një gjë të tillë me shkrim nga Bordi Drejtues jo më vonë se 14 ditë para datës së mbajtjes së Kuvendit. Kërkesa nga ky paragraf duhet të përmbajë emrin dhe numrin e aksioneve të secilit propozues, si dhe datën e parashtrimit të saj. Për qëllime të këtij paragrafi, asnjë aksionar nuk mund të numërohet më shumë se në një grup të aksionarëve që mbajnë së paku 10% të votave.

## **KREU III – UDHËHEQJA, PUNIMET DHE DOKUMENTACIONI I KUVENDIT**

### **Neni 6**

#### **Udhëheqja e Kuvendit**

6.1 Me punën e Kuvendit udhëheq Kryetari i Kuvendit. Në mungesë të Kryetarit të Kuvendit, për çfarëdo arsye, mbledhjet e Kuvendit i udhëheqë anëtar i vjetër i Kuvendit të Aksionarëve, i cili i bartë të gjitha kompetencat e Kryetarit të Kuvendit sa i përket punimeve të Kuvendit.

6.2 Mbledhjen e Kuvendit e hapë Kryetari i Kuvendit i cili edhe propozon organet e punës së Kuvendit. Organe të punës së Kuvendit mund të jenë Kryesia e Punës, Komisioni Verifikues dhe Procesmbajtësi. Zgjedhja e organeve të punës së Kuvendit duhet t'i paraprijë punimeve të Kuvendit.

6.3 Kryesia e Punës të Kuvendit do të caktohet në rast se Kuvendi i Aksionarëve përbëhet nga më shumë se 50 aksionarë me të drejtë vote në të.

6.4 Komisioni Verifikues duhet të vërtetojë se në mbledhje marrin pjesë një numër i mjaftueshëm i delegatëve për të plotësuar kuorumin e domosdoshëm për marrjen e vendimeve në Kuvend, në pajtim me Statutin e Shoqërisë, dhe konstituohet vetëm në rastet kur Kryetari nuk është në gjendje të vërtetojë se të pranishëm në Kuvend janë zotëruesit e aksioneve të domosdoshme për të marrë vendime sipas Statutit dhe kësaj Rregulloreje.

6.5 Pas krijimit të organeve të punës së Kuvendit dhe konstatimit se ekziston kuorumi, Kryetari i Kuvendit propozon miratimin e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit. Miratimi i rendit të ditës bëhet me shumicë votash, ndërsa çdo aksionar ka të drejtë të propozojë ndërrimin ose plotësimin e rendit të ditës të Kuvendit të Rregullt.

6.6 Pika e parë e rendit të ditës të çdo Kuvendi të Shoqërisë do të jetë miratimi i procesverbalit nga Kuvendi paraprak, i cili duhet t'u dërgohet të gjithë aksionarëve krahas dokumentacionit tjetër përgatitor të Kuvendit.

6.7 Pika e dytë e rendit të ditës të çdo Kuvendi të Shoqërisë do të jetë raportimi nga Kryetari i Kuvendit, Bordi i Drejtorëve, apo një personi tjetër të autorizuar mbi veprimtarinë e Shoqërisë mes dy Kuvendeve.

#### **Neni 7**

#### **Diskutimet në Kuvendin e Aksionarëve**

7.1 Diskutuesi në Kuvendin e Aksionarëve mund të flasë vetëm për çështjen e cila është duke u shqyrtuar sipas rendit të ditës. Nëse diskutimi devijon nga rendi i ditës, Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia tërheq vërejtjen ose ta ndërpresë diskutimin.

7.2 Asnjë diskutues në Kuvendin e Aksionarëve nuk mund ta marrë fjalën më tepër se një herë për një pikë të caktuar të rendit të ditës. Diskutimi i aksionarëve në Kuvendin e Aksionarëve mund të zgjasë më së shumti pesë (5) minuta.

7.3 Secili aksionar ka të drejtë në një replikë (e cila zgjatë jo më shumë se një minutë) nëse i përmendet, apo i apostrofohet emri në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

#### **Neni 8**

#### **Dokumentacioni i Kuvendit**

8.1 Procesverbali i secilës mbledhje të aksionarëve duhet të përgatitet menjëherë pas mbledhjes dhe duhet të nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Shoqërisë, që është përgjegjës për saktësinë e procesverbalit.

8.2 Procesverbali përpilohet brenda një jave pas përfundimit të Kuvendit dhe i përmban të gjitha

elementet e përcaktuara në këtë Rregullore. Procesverbali përfshin (i) datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, (ii) rendin e ditës, (iii) kuorumin, (iv) fletëvotimet si dhe procedurat tjera të votimit, (v) numrin e votave të cilat i posedojnë aksionarët dhe përfaqësuesit e tyre në mbledhje, (vi) emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe secilit sekretar të mbledhjes, (vii) çështjet të cilat janë votuar dhe rezultatet e votimit, (viii) një përmbledhje të fjalimeve dhe diskutimeve (përfshirë ndonjë fjalim lidhur me ndonjë votë negative apo abstenim), dhe (ix) një listë të vendimeve të marra në mbledhje.

8.2 Të gjitha vendimet, aktet normative dhe udhëzimet e miratuara nga Kuvendi do të mbahen në arkiv të veçantë, i cili mirëmbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqërisë, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Kuvendit. Të njëjtat janë në dispozicion të të gjithë aksionarëve dhe Bordit Drejtues, në çdo kohë.

## **KREU IV - VOTIMI NË KUVEND DHE ZGJEDHJA E ORGANEVE**

### **Neni 9**

#### **Marrja e vendimeve të Kuvendit**

9.1 Kuvendi i Aksionarëve i miraton vendimet dhe konkluzionet e veta me shumicë votash. Propozimi për të cilin votohet, konsiderohet si i aprovuar vetëm nëse për të deklarohen më tepër se 50% të aksioneve të pranishme në Kuvendin për të cilin është konstatuar kuorumi.

9.2 Përjashtimisht dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni, votimi për çështjet e përcaktuara në nenin 15.2 të Statutit të Shoqërisë dhe votimi për çështje tjera për të cilat është e paraparë një shumicë e kualifikuar e aksioneve duhet të miratohen nga shumica e kualifikuar e përcaktuar në dispozitat përkatëse.

9.3 Votimi në Kuvendin e Aksionarëve është publik, përveç në rastet kur Kuvendi i zgjedh organet e veta, kur votimi mund të bëhet në mënyrë të fshehtë, të hapur apo me aklamacion.

9.4 Votimin me vota të fshehura e koordinon Sekretari i Përgjithshëm i Shoqërisë, nën udhëheqjen e Kryetarit të Kuvendit.

### **Neni 10**

#### **Zgjedhja e organeve**

10.1 Kuvendi i Aksionarëve është ekskluzivisht kompetent për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe Bordit Drejtues të Shoqërisë, në pajtim me Statutin e Shoqërisë.

10.2 Të drejtën e propozimit të kandidatëve për Kryetar të Shoqërisë e kanë a) Bordi Drejtues i Shoqërisë i cili mund të propozojë një kandidat, dhe b) bartësit e së 10% të aksioneve të Shoqërisë, të cilët mund ta propozojnë një kandidat për Kryetar. Në rast të zgjedhjes me votim të hapur apo të fshehur, Kryetar i Shoqërisë konsiderohet kandidati që ka fituar së paku votat e së paku një aksioni mbi vlerën e gjysmës së aksioneve të Shoqërisë. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për

Kryetar të Kuvendit nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin në rrethin e dytë të votimit aksionarët e pranishëm në Kuvend votojnë vetëm dy kandidatët të cilët në rrethin e parë të zgjedhjeve kanë gëzuar përkrahjen më të madhe të aksionarëve të pranishëm në Kuvend. Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar i Kuvendit zgjedhet kandidati i cili ka fituar përkrahjen e shumicës së aksioneve të Shoqërisë. Kryetari i Kuvendit, i cili me automatizëm është edhe Kryetar i Bordit Drejtues të Shoqërisë, do të ketë mandat trevjeçar, me të drejtë të pakufizuar rizgjedhjeje.

10.3 Përveç Kryetarit të Bordit Drejtues dhe pas zgjedhjes së tij, Kuvendi i Aksionarëve zgjedhë edhe katër drejtorë tjerë, me mandat trevjeçar dhe të drejtë të pakufizuar rizgjedhjeje. Anëtarët e Bordit Drejtues mund të zgjedhen me votim të hapur, votim të fshehur dhe aklamacion. Mandati i Bordit Drejtues mund të konfirmohet çdo vit në Kuvendin e Rregullt të Shoqërisë. Të drejtën e propozimit të kandidatëve për Bordin e Drejtorëve do ta kenë: Kryetari i Bordit, i cili propozon dy kandidatë, dhe të gjithë aksionarët që zotërojnë mbi 10% të aksioneve në Shoqëri të cilët kanë të drejtë të propozojnë nga një kandidat për drejtor në Bordin Drejtues. Në rast të zgjedhjes me votim, anëtarë të Bordit Drejtues zgjedhen katër kandidatët që kanë fituar përkrahjen më të madhe të aksioneve që kanë votuar në Kuvend.

10.4 Procedurat e zgjedhjes së organeve përmes votimit të fshehtë do të koordinohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqërisë, nën udhëheqjen e Kryetarit të Kuvendit.

## **KREU V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 11**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore konsiderohet miratuar aprovuar po që se për të voton shumica e aksioneve në Kuvendin e Aksionarëve. Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje, bëhen në të njëjtën mënyrë dhe në bazë të së njëjtës procedurë sikurse edhe miratimi i saj.

## **KUVENDI I AKSIONARËVE TË BPrAL KOLEGJI RIINVEST sh.a.**

---

**Kryetari i Kuvendit të Aksionarëve**

Rasim Mrlaku

Prishtinë, 16 nëntor 2017